

ENGLISON QOSE – ADZM BERAT

Drejtor i Administratës së Zonave të Mbrojtura Berat (ADZM Berat).

Z. Englison Qose ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Berat që prej prillit 2026.

Me formim në fushën e inxhinierisë pyjore, z. Qose është diplomuar në vitin 2014 pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore të Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku ka fituar titullin “Inxhinier Pyjesh” dhe gradën “Master Shkencor” në Inxhinieri Pyjesh. Gjatë studimeve dhe më pas ka ndjekur trajnime të ndryshme dhe është angazhuar në projekte për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore dhe mjedisore.

Karrierën profesionale e ka nisur pranë Administratës së Zonave të Mbrojtura Berat, ku ka shërbyer si Specialist i Monitorimit, duke u angazhuar në monitorimin e florës dhe faunës, mbrojtjen e ekosistemeve dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Më pas, gjatë periudhës 2019–2026, ka shërbyer si Administrator i Njësisë Administrative Roshnik pranë Bashkisë Berat, ku është angazhuar në administrimin e territorit, koordinimin e shërbimeve publike dhe ndjekjen e projekteve të zhvillimit vendor.

Në detyrën aktuale, z. Qose sjell një përvojë të ndërthurur në fushën e mjedisit, administrimit të territorit dhe menaxhimit institucional, me fokus në mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.